



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/68

Datë: 08.01.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 13 të Ligjit nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më datë 8 Janar 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Pensioni kontributpagues i moshës sipas përvojës së punës llogaritet sipas vlerës 0.5% për çdo vit të shumës aktuale të këtij pensioni.
2. Në mungesë të dëshmive për vërtetimin e përvojës së punës sipas pikës 1. të këtij vendimi, çdo pensionisti i cili ka pesëmbëdhjetë (15) vjet përvojë pune, në mënyrë automatike, i njihet përvoja shtesë e punës prej njëzetepesë (25) vitesh e cila është e barazvlefshme me 12.5 % të shumës aktuale të pensionit kontributpagues të moshës, vlera e të cilës është njëqindëekatërdhjetë (140) euro.
3. Vlera e pensioneve kontributpaguese të moshës sipas përvojës së punës është njëqindëepesëdhjetëetë (158) euro.
4. Vlera e pensioneve kontributpaguese sipas strukturës kualifikuese, do të përcaktohet pas datës 31 mars 2016 dhe pas verifikimit mbi kualifikimin e pensionistëve kontributpagues.
5. Të gjithë pensionistët kontributpagues të moshës të cilët aplikojnë deri më 31 mars 2016, do të paguhën në mënyrë retroaktive nga data 1 janar 2016.
6. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Ministria e Financave.
7. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/68


Datë: 08.01.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 8 Janar 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Mbështeten Konkluzionet e dala nga takimi i VI i Këshillit të Ministrave për Reformën e Administratës Publike.
2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Institucionet të cilat kanë obligime nga Konkluzionet sipas pikës 1. të këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/68
Datë: 08.01.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 dhe 50 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 8 Janar 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

PËR THEMELIMIN E EKIPI T NEGOCIATOR PËR NEGOCIIMIN E KONTRATËS SË REFORMAVE TË SEKTORIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE SI PJESË E PËRKRAHJES BUXHETORE SEKTORIALE NGA PROGRAMI IPA 2016 NDËRMJET REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE BASHKIMIT EVROPIAN

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij vendimi është krijimi i ekipit negociator për drejtimin e përgatitjeve dhe negociatave të Qeverisë së Republikës së Kosovës për lidhjen e Kontratës së Reformave të Sektorit të administratës publike, si pjesë e përkrahjes buxhetore sektoriale nga programi IPA 2016, në mes Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian (më tej i referuar si Ekipi Negociator).

Neni 2
Përbërja e Ekipit Negociator

1. Ekipi Negociator përbëhet nga përfaqësuesit:
 - 1.1. Ministria e Integrimit Evropian, Kryesues;
 - 1.2. Ministria e Administratës Publike;
 - 1.3. Ministria e Financave;
 - 1.4. Zyra Ligjore - Zyra e Kryeministrit;
 - 1.5. Sekretariati Koordinues i Qeverisë - Zyra e Kryeministrit;
 - 1.6. Zyra për Planifikim Strategjik, Zyra e Kryeministrit.
2. Nëse kërkohet me agjendë, në takimet e Ekipit Negociator, Kryesuesi mund të ftojë udhëheqës apo ekspertë të institucioneve të tjera shtetërore të Republikës së Kosovës.

Neni 3
Funksionet e Ekipit Negociator

1. Ekipi Negociator ka funksionet dhe obligimet e mëposhtme:
 - 1.1. të koordinoj politikat shtetërore në negociatat me Bashkimin Evropian për Kontratën e Reformës së Sektorit të administratës publike;
 - 1.2. të diskutoj pozitat negociuese dhe çdo çështje tjetër që lidhet me negociatat për Kontratën e Reformës së Sektorit të administratës publike;
 - 1.3. të veproj si delegacion i Republikës së Kosovës në takimet zyrtare në negociatat për Kontratën e Reformës së Sektorit të administratës publike;
 - 1.4 të koordinoj përgatitjet e institucioneve shtetërore për negociatat për Kontratën e Reformës së Sektorit të administratës publike;
 - 1.5. të informoj dhe t'i raportoj rregullisht Qeverisë dhe të gjitha institucioneve tjera relevante për të gjitha çështjet e hapura dhe progresin e arritur në negociatat për Kontratën e Reformës së Sektorit të administratës publike.

Neni 4
Mbështetja administrative


Ministria e Integrimit Evropian, në bashkëpunim dhe koordinim me të gjitha njësitë organizative të përfaqësuara në Ekipin Negociator, do të jetë përgjegjëse për mbështetjen administrative të Ekipit Negociator.

Neni 5
Procesverbalet e mbledhjeve

Procesverbalet e mbledhjeve duhet të nënshkruhen nga Kryesuesi dhe shpërndahen te të gjithë anëtarët e Ekipit Negociator dhe titullarët e institucioneve shtetërore pjesëmarrëse në takime, brenda tri ditëve të punës pas mbajtjes së takimit.

Neni 6
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë